



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura III

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 02. 03. 2010, në orën 12: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P r o c e s v e r b a l**

**Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e Parlamentit Italian.**

**Nga delegacioni i Parlamentit Italian morën pjesë:** z. Stefano Stefani, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme, z. Roberto Antonione, shef i Grupit PDL, z. Piero Fassino, PD, z. Gennaro Malgieri, PDL, z. Mario Barbi, PD, z. Mario di Napoli, sekretar i Komisionit për Pune të Jashtme z. Floris De Gou, zyrtar në Parlament dhe z. Michael L. Giffoni, ambasador i Italisë në Prishtinë.

**Në takim nga Komisioni morën pjesë:** z. Sabri Hamiti, z. Enis Kervan, z. Xhavit Haliti, z. Ramë Buja, z. Ibrahim Gashi, z. Ardian Gjini, z. Nexhat Daci dhe z. Slobodan Petroviq.

**Mungoi:** z. Lutfi Haziri.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

**R E N D I I D I T Ë S**

**1. Takim me delegacionin e Parlamentit Italian**

**Sabri Hamiti** - Ju shprehu mirëseardhje delegacionit italian, të kryesuar nga Stefano Stefani, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme. I prezantoi anëtarët e Komisionit, i njoftoi për strukturën e Kuvendit dhe për koalicionin qeverisës. Kuvendi ka hartuar legjislacion bazë për ndërtimin e Kosovës dhe këto dy vitet e fundit është angazhuar për ndërtimin e strukturave përfaqësuese të vendit. Në politikën e jashtme objektiv themelor i shoqërisë sonë, mbetet sa më shumë njohje të shtetit të ri dhe integritet evropian. Në planin e brendshëm problemet e shoqërisë qëndrojnë në zhvillimin ekonomik dhe në shtet-ndërtimin e tij.

E falënderoi shtetin italian dhe të gjitha vendet që e ndihmuan Kosovën në periudhën e luftës, pasluftës, të rindërtimit, si dhe ndihmën e dhënë në kuadër të forcave të sigurisë.

**Stefano Stefani** – E prezantoi delegacionin, anëtarët e Komisionit për Punë të jashtme të Parlamentit Italian. I njoftoi se delegacioni e realizon këtë vizitë në Kosovë në bazë të planit të Ministrit për Punë të Jashtme të Italisë.

Numri i ushtarëve italianë në Kosovë do të zvogëlohet. Arsyeja e vizitës është të njoftohemi me gjendjen e sigurisë në Kosovë. Kërkoj të informohet për sigurinë e manastireve, përmes tenderëve a ka rritje të investimeve italiane në Kosovë, çfarë është zhvillimin ekonomik në Kosovë, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit në ekonominë botërore dhe a është zvogëluar papunësia në Kosovë?

**Roberto Antonione** - Kërkoj të informohet se cili është opinionin publik kosovar rreth integritetit evropian dhe cila është strategjia e këtij rrugëtimi?

**Piero Fassino** - Deklaroi se perspektiva e stabilitetit për Ballkanin është e lidhur me integrimin në BE të të gjitha vendeve të këtij rajoni. Njëra nga kushtet që e favorizon Kosovën në rrugën drejt BE- së është një marrëveshje mes Beogradit, e cila arrihet vështirë, kur t'i kërkohej Beogradit ta njohë realitetin në Kosovë. Shtroi pyetjen se në bazë të cilave pika duhet të arrihet marrëveshja me Serbinë?

**Mario Barbi** - Shtroi pyetjen se sa është ndikimi i të hyrave të emigrantëve për ekonominë kosovare dhe sa është stabil ky koalicion me 62 deputetë në 120. Numri i komuniteteve është 10 në 120 deputetë, nëse nuk gaboj, cilat janë raportet e minoriteteve me mazhurancën dhe Qeverinë dhe çfarë përfshirje mund të kenë në mazhurancë e Qeveri, me qëllim që të arrihet një marrëveshje, që folën parafolësit, për integrim drejt BE - së.

**Stefano Stefani** – I njoftoi se në një Deklaratë të Vjenës është thënë se duhet bërë një integrim më i madh i komunitetit serb në institucionet e Kosovës. Kërkoj të njoftohet nga deputeti S. Petroviq, pse ka pasur aq dallim të madh të pjesëtarëve serbë në zgjedhjet e fundit, në mes të pjesës së veriut me pjesët e tjera të Kosovës?

**Slobodan Petroviq** – I njoftoi se në Kuvendin e Kosovës janë 10 vende të garantuara për deputetët e komunitetit serb dhe 10 të komuniteteve të tjera. Partia Liberale Serbe ka edhe dy përfaqësues në Qeveri. Partia Liberale Serbe ka qëndrim të qartë se komuniteti serb duhet të marrë pjesë në institucionet e Kosovës dhe se integrimi i serbëve është i pashmangshëm. Në pjesën e veriut të Kosovës është situata më ndryshe, pasi atje ka shumë pushtete ose është pa pushtet, nuk kemi pasqyrë të qartë të zgjedhjeve. Në këtë pjesë nuk është punuar në mënyrë adekuate, janë investuar mjaft mjete, por në duar të gabuara. Me procesin e decentralizimit, në zgjedhjet e fundit lokale, sipas Planit të Ahtisaarit, janë formuar komuna të reja, ku jetojnë shumica e përfaqësuesve të komunitetit serb, ajo e Graçanicës, e Klllokotit, e Ranillukut, komuna e zgjeruar e Novobërdës, dhe komuna e Parteshit. Në komunën ekzistuese të Shtërpçës, për herë të parë numri i votuesve ka qenë 55%. Falënderojmë shtetin italian për ndihmën e afuar Kosovës.

**Sabri Hamiti** - Duke u përgjigjur në pyetjen e Mario Barbit tha se në Kuvendin e Kosovës nga 120 ulëse, 23 janë të komuniteteve të tjera. Në Qeverinë e Kosovës ka 2 ministra të komunitetit serb, 1 turk, 2 zëvendësministra turkë dhe 3 zëvendësministra boshnjakë dhe 1 zëvendësministër serb. Ndërsa sa i përket koalicionit është arritur koalicion mes dy partitive më të mëdha, si i nevojshëm për fazën e shpalljes së pavarësisë, ndërsa numri po ashtu është më i madh se 62, sepse ngërthen në vete edhe partitë e komuniteteve të tjera. Paratë e emigrantëve ndikojnë në mbajtjen e shumë familjeve në Kosovë. Lidhur me pyetjen për marrëveshje me Serbinë, me qëllim të integritetit drejt BE- së tha se të gjitha institucionet e Kosovës deklarojnë se me Serbinë mund të bisedohet për të gjitha çështjet e interesit të përbashkët, por nuk mund të bisedohet për statusin e Kosovës.

Rreth pyetjes për zvogëlimin e numrit të KFOR- it italian dhe sigurisë së manastireve, tha se siguria e manastireve nuk ka qenë asnjëherë në pikëpyetje, ato janë prona kulturore të Kosovës. Institucionet fetare nuk janë të rrezikuara në Kosovë për asnjë moment, nëse nuk shndërrohen në qendra politike.

**Nexhat Daci** – Tha se në cilësi të pozitës ose opozitës ne nuk dallojmë sa i përket drejtimit të politikës së jashtme të Komisionit dhe të Qeverisjes në përgjithësi, ndërsa në pyetjet konkrete ka anësi në mes të pozitës dhe opozitës. Mendon se komunat me shumicë të popullatës serbe dhe popullata që është e inkuadruar në sistemin qeverisës në Kosovë duhet të ketë më tepër përkrahje në aspektin e zhvillimit ekonomik, sepse në atë mënyrë do të bëhej integrimi më i shpejtë dhe komunitetet do të jenë urë lidhëse e proceseve të integrimi evropiane, e jo arsye e ndarjes.

Dhënia prioritet e kahut tjetër në Kosovë, në këto dy vite të pavarësisë ka rritur krimin e organizuar në Kosovë. Ekonomia që depërton nga kufiri i hapur në veri të Kosovës, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi dhe asnjë rregulli, e dëmton ekonominë e vogël që sillet konform ligjeve. Duke u fituar përkrahja e komunitetit serb në komunat e reja, do të detyrohej Beogradi zyrtar që të kemi një marrëveshje të udhëtimit të përbashkët në Bruksel, të integrimi euroatlantike. Propozoi që komisionet e jashtme të shteteve të BE- së dhe ato që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të vizitojnë parlamentin tonë, që diplomacia parlamentare të jetë më aktive.

**Ibrahim Gashi** – E falënderoi KFOR- in italian për kontributin që ka dhënë dhe shtoi se ushtarët italianë, sigurisht do ta japin mendimin se manastiret nuk kanë qenë të rrezikuara asnjëherë.

Po ashtu falënderoi për kontributin që jep Italia në punësimin sezonal të punëtorëve tanë në Itali dhe ndihmën e dhënë gjatë procesit të shtetndërtimit të Kosovës.

**Piero Fassino** – Tha se është shumë e qartë për ne dhe pjesën më të madhe të komuniteti ndërkombëtar se Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme, cila është ideja kosovare që do ta detyroj Serbinë për ta pranuar pavarësinë e Kosovës?

**Sabri Hamiti** – Tha se ne mendojmë shtrirja pushtetit dhe ligjit në tërë territorin e Kosovës dhe integrimi i komunitetit serb në gjithë territorin e Kosovës është hapi i parë i komunikimit të Kosovës me Serbinë. Atëherë do të bjerë elementi i përdorimit të situatës së serbëve në Kosovë për interesa parciais politike në Beograd, atëherë do të kemi nevojën e komunikimeve të domosdoshme ekonomike dhe politike me Serbinë në Ballkanin Perëndimor, atëherë do të kemi nevojë për marrëveshje, sepse edhe ne edhe Serbia aspirojmë të shkojmë në BE dhe e dimë se nuk do të mund të shkojmë pa i rregulluar raportet në mes vete. Këto kërkojnë një kohë, por ekziston vullneti i Kosovës, që të krijohen kushtet që të shihemi duke e njohur njëri - tjetrin në BE. Ky është një konsensus i politikës së jashtme të Kosovës ndaj BE – së dhe ndaj Serbisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 55

Kryetari i Komisionit

---

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për mbështetje të Komisionit